



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 205, datë 11.10.2019

PËR

PEZULLIMIN E PROCEDURËS SË KOMANDIMIT PËR POZICIONIN E NËPUNËSIT PËRGJEGJËS PËR VLERËSIMIN

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 pika 3 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 54 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 11 dhe 67 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr.104 datë 05.07.2019 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtarëve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale ,

VENDOSI:

1. Pezullimin e procedurës të komandimit për dy pozicionet e shpallura për “nëpunës përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, deri në përfundim të shqyrtimit të statusit të ish/inspektorëve dhe përbërjes së kësaj Njësie.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR